

# KRIJIMI I BORDIT TE ZHVILLIMIT EKONOMIK PRANE BASHKIVE Shembulli i bashkisë Shkodër



Ky dokument u prodhua si pjesë e inisiativave publike të pjesëmarrësve të “Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike” dhe u mbështet nga Akademia e Studimeve Politike. Ofrimi i ekspertizës profesionale të këtyre hulumtimeve ndaj politikëbërësve synon të sigurojë një platformë diskutimesh për shkëmbimin e ndërsjelltë të ideve të reja.

Përgatiti:

Senida Mesi  
Olta Kepucka  
Besard Buzi  
Julinda Mansaku  
Romira Muka  
Armela Mitku

# Bordi i Zhvillimit Ekonomik pranë Njësive të Qeverisjes Vendore (NJQV) si domosdoshmëri për zhvillimin dhe mirëqenien e komunitetit dhe nxitës për mirëqeverisje; Bashkia Shkodër

---

## Permbajtje

1. Hyrje : .....	3
1.1. Metodologjia .....	5
1.2. Hipoteza .....	5
2. Bordet e zhvillimit dhe Bashkia Shkodër .....	5
2.1. Çfarë është bordi.....	5
2.2. Komisioni i Planifikimit Strategjik të Zhvillimit Ekonomik të Bashkisë Shkodër .....	6
3. Parimi i pjesëmarrjes në vendimmarrje .....	7
4. Qeverisia vendore, ligji dhe bordet e zhvillimit: .....	10
4.1. Referenca ligjore .....	10
4.2. Përfshirja e publikut .....	11
4.3. Krijimi i strukturave ndihmese, siç janë Bordet .....	11
5. Diskutime, pritshmeri dhe sugjerime .....	13
5.1. Pritshmëri .....	13
5.2. Rekomandime: .....	14

## Shkurtime:

NJQV\_ Njësi e Qeverisjes Vendore

PPV\_ Plan i Përgjithshëm vendor

PZHS\_ Plan i Zhvillimit Strategjik

PBA\_ Plan Buxhetor Afatmesëm

KB\_ Këshill Bashkiak

KEAV\_ Karta Europiane e Autonomise Vendore

OJF\_ Organizata Jo qeveritare

# Bordi i Zhvillimit Ekonomik pranë Njësive të Qeverisjes Vendore (NJQV) si domosdoshmëri për zhvillimin dhe mirëqenien e komunitetit dhe nxitës për mirëqeverisje; Bashkia Shkodër

---

## 1. Hyrje :

Vitet e fundit i është dhënë shumë rëndësi parimit të autonomisë vendore, duke synuar që gjithnjë e më shumë NJQV të jenë sa më autonome dhe pushteti të decentralizohet.

Me këtë mënyrë synohet të realizohet dhe parimi i subsidiarititetit, i cili specifikon që përgjegjësitë publike duhet të ushtrohen përgjithësisht nga ato autoritete që janë më pranë qytetarëve, pra i kryerjes së funksioneve dhe ushtrimit të kompetencave në një nivel qeverisjeje sa më pranë komunitetit. Alokimi i përgjegjësive një autoriteti tjetër duhet të gjykohet në përputhje me shtrirjen dhe natyrën e detyrës dhe kërkesat e eficientës dhe ekonomisë<sup>1</sup>.

Gjate 2 viteve të fundit NJQV janë hasur me një sërë ndryshimesh ligjore dhe rritje kompetencash. Kështu ligji mbi reformën e re territoriale, ligji i ri mbi qeverisjen lokale, akte nënligjore të shumta që shërbejnë për mirë rregullimin e kompetencave të shtuara, funksioneve të reja të transferuara nga qeverisja qendrore, mes nevojës për më shumë decentralizim dhe sfidës së financave të vakta i vendosin Bashkitë e reja përballë vështirësive të mëdha në ofrimin e shërbimeve të standartizuara dhe me cilësi për banorët e tyre. Sikur të mos mjaftonte kjo, stafi i pakualifikuar mjaftueshëm dhe domosdoshmëria për të rritur mirëqenien ekonomike dhe sociale të banorëve të Bashkive rrit dhe me tej sfidën e Bashkive. Krijimi i njësivë tepër të mëdha, nga zona me diversifikim të madh mentaliteti, tradite, formimi dhe mënyre jetese, zhvillimi ekonomik, edukimi, mund të shoqërohet me specifika negative si: largimi i shërbimit dhe vendimmarrjes nga përfituesi, largim të banorit të thjeshtë nga strukturat vendimmarrëse, rënie të nivelit të përfaqësimit të komunitetit dhe kryerja e shërbimeve bazë gjithnjë e më larg përfituesit, zhvillimi disproporcional dhe jo i intergruar i zonave.

Që një NJQV të jetë efiçente dhe të realizojë misionin e saj me sukses në këtë kuadër kompleks, të ri, dhe shumë divers, mendojmë se mirëqeverisja në bazë të normave dhe kërkesave ligjore do të jetë një avantazh për të gjitha ato Bashki që do të dinë ta përdorin dhe ta vënë në funksion për të mirën e komunitetit.

Qeverisja e mirë është “mënyra se si pushteti ushtrohet në menaxhimin e burimeve ekonomike dhe sociale të një vendi në zhvillim”<sup>2</sup>. Ajo përfshin gjithashtu kapacitetin e qeverisë për të menaxhuar me efikasitet burimet e veta dhe për të zbatuar politika të përshtatëshme, si dhe ekzistencën e një kontrolli demokratik mbi agjentët e ngarkuar nga autoriteti<sup>3</sup>.

Qeverisja e mirë është ndërveprimi i institucioneve publike, trupave politike, dhe shoqërisë duke përfshirë sisteme të përfshirjes, lobimit dhe koalicioneve. Synimi i një qeverisjeje të tillë është ndërveprimi me publikun me qëllim realizimin e interesit të përbashkët dhe legjitimitimitin e qeverisjes. Në nivel lokal mirëqeverisja shihet si një mënyrë për të qeverisur më me ekuilibër, më

---

<sup>1</sup>Ligj 139/2015, neni 4, paragrafi 3

<sup>2</sup>Sipas definicionit të Bankës Botërore

<sup>3</sup>Sipas [www.shtetiweb.org](http://www.shtetiweb.org)

# Bordi i Zhvillimit Ekonomik pranë Njësive të Qeverisjes Vendore (NJQV) si domosdoshmëri për zhvillimin dhe mirëqenien e komunitetit dhe nxitës për mirëqeverisje; Bashkia Shkodër


gjithpërfshirëse, duke synuar përdorimin me efikasitet të burimeve në dispozicion dhe shërbyer nevojave pa kufi të komunitetit që mbulon.

Për një mirëqeverisje duhet të kemi parasysh një seri faktorësh (ref: diagram 1), ku nëse qeverisja bëhet sipas ligjit dhe ligji mbizotëron mbi çdo vendimarrje, për çdo veprim ose mosveprim mbahet përgjegjësi e plotë, qeverisja është përfshirëse dhe nxit pjesëmarrjen e komunitetit dhe jo vetëm i informon ato ato të dyja palët së bashku kanë realizuar misionin dhe “Kontratës sociale”, ku sovrani vendos dhe delegon, dhe qeveria zbaton dhe jep llogari.



Për të kuptuar marrëdhënien midis zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies Diagram 2 më poshtë jep lidhjen midis faktorëve të ndryshëm:

*Zhvillimi ekonomik dhe menaxhimi i burimeve natyrore akoma te patrajtura*



- 
- Deri tani zhvillimi ekonomik, menaxhim i burimeve natyrore dhe i territorit ne funksion te zhvillimit nuk kane ndonje eksperience te konsoliduar ne nivel lokal
- Cilesia e sherbimeve dhe e mireqenies varet pikerisht nga mundesia e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimi i burimeve

**Diagram 2**

# Bordi i Zhvillimit Ekonomik pranë Njësive të Qeverisjes Vendore (NJQV) si domosdoshmëri për zhvillimin dhe mirëqenien e komunitetit dhe nxitës për mirëqeverisje; Bashkia Shkodër

---

## 1.1. Metodologjia

Kjo është një temë përshkuese dhe për realizimin e saj do të ndiqet metoda cilësore. Për vërtetimin e hipotezës së mësipërme i jemi referuar, Kushtetutës së Shqipërisë dhe neneve përkatëse, Kartës Evropiane gjithashtu literaturave teorike të cilat shpjegojnë konceptet e 'bordit zhvillimor' dhe parimit të 'pjesëmarrjes'.

## 1.2. Hipoteza

Angazhimi qytetar, i specialistëve të fushës dhe sipërmarrësve në një Bashki, përmes themelimit të *Bordit të Zhvillimit Ekonomik*, nxit pjesëmarrjen, përfshirjen e komunitetit, duke përmirësuar qeverisjen e NJQV, përmes ndikimit të drejtë për drejtë në ndërtimin së bashku të politikave zhvillimore ekonomike, strategjive të zhvillimit (PSZH), apo duke suportuar në ndërtimin e planeve të përgjithshëm vendor (PPV), planeve afatmesëm buxhetore (PBA) dhe planeve afatshkurtër buxhetore.

Synimi është të përdoren me efikasitet burimet financiare, të kemi rritje të biznesve dhe punësimi. Të përmirësohet klima e biznesit në përgjithësi, e cila me pas të favorizojë një zhvillim social dhe zbutje të varfërisë.

## 2. Bordet e zhvillimit dhe Bashkia Shkodër

### 2.1. Çfarë është bordi

Bordi është një grup i cili mblidhet për të arritur zhvillim strategjik të kompanisë, ka minimumi një drejtues të pavarur dhe një drejtues – pronar si drejtues ekzekutivë. Bordi është një grup individësh të cilët mund të shkëputen nga punët e përditshme dhe të mbikëqyrin biznesin, një grup që mund të debatojë probleme të vështira dhe sjell vendime të qarta për kompaninë, dhe së fundmi një grup që drejton dhe është besnik ndaj kompanisë.<sup>4</sup>

Ne baze të ligjit aktual, NJQV kanë të drejta dhe përgjegjësi të krijojnë komitete, borde ose komisione për kryerjen e funksioneve të veçanta sa herë që paraqitet nevoja, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore.

---

<sup>4</sup> <https://www.iod.org.nz/FirstBoards/What-is-a-board>

# Bordi i Zhvillimit Ekonomik pranë Njësive të Qeverisjes Vendore (NJQV) si domosdoshmëri për zhvillimin dhe mirëqenien e komunitetit dhe nxitës për mirëqeverisje; Bashkia Shkodër

---

Bordi i zhvillimit ekonomik i ndërtuar nga Bashkia e Shkodrës dhe partnerë ka formën e një bordi formal dhe meqenëse shembulli që ne kemi zgjedhur për këtë punim është ky bord atëherë po paraqesim karakteristikat e tij teorike duke kaluar më pas në shembullin e aplikuar nga Bashkia Shkodër. Një bord formal ka këto karakteristika ; propozohet/emërohet nga Kryetari i Bashkisë me vendim të Keshillit Bashkiak . Ai manaxhon, drejton dhe mbikqyr çështjet që i janë deleguar apo ka marrë përsipër për të trajtuar, është përgjegjës për veprimet e tij, kalon dhe aprovon strategjitë e zhvillimit. Siç e shohim qartë këto karakteristika aq sa i japin pushtet bordit i kërkojnë edhe përgjegjësitë përkatëse.

## 2.2. Komisioni i Planifikimit Strategjik të Zhvillimit Ekonomik të Bashkisë Shkodër

Në kuadër të programit Drejtimi i Ekonomisë Lokale nëpërmjet Teknikave dhe Aleancave (DELTA) është hartuar një strategji për Zhvillimin Ekonomik Vendor (ZhEV) të bashkive të ndryshme në Shqipëri. Programi u zbatua në Shqipëri gjatë periudhës 2004–2005 dhe u mbështet financiarisht e teknikisht nga Banka Botërore (BB; Departamenti i Zhvillimit Ekonomik Vendor) dhe Instituti për Shoqëri të Hapur (SOROS), nëpërmjet Iniciativa për Qeverinë Vendore dhe Reformën në Shërbimet Publike (LGI), Hungari. Në bashkëpunim me organizatën shqiptare Fondacioni për Autonomi Vendore dhe Qeverisje (FLAG) u përgatit një strategji për, dhe në bashkëpunim me secilën nga bashkitë e Beratit, Durrësit, Korçës, Lezhës dhe Shkodrës. Qëllimi i këtij programi ishte dhe vazhdon të jetë të zhvillojë plane strategjike të veprimit që do ndikojnë në reformimin e politikave të zhvillimit ekonomik vendor në nivel bashkiak, veçanërisht të sektorit privat.<sup>5</sup> Përmirësimi i qeverisjes përmes pjesëmarrjes si dhe rritja e transparencës është themeli i objektivit të rastit studimor të realizuar nga Bashkia Shkodër. Sipas materialit të marrë nga kjo bashki: Programi i përfshirjes qytetare në hartimin e strategjisë së zhvillimit ekonomik u bazua në tre aktivitete kryesore :

- Shkëmbimi (shpërndarja) e informacionit
- Konsultimi publik, ku shqetësimet, opinionet dhe këshillat diskutohen në mënyrë aktive
- Mbështetja e përpjekjeve për informim dhe iniciativave konsultuese

Këto tre elemente të programit sigurojnë bazën për hartimin e një programi të pjesëmarrjes publike, *shpërndarja e informacionit* u realizua nga Ftesat Zyrtare për Pjesëmarrje, e cila u përgatit në formë komunikimi personal. Gjithashtu për persona të një rëndësie të veçantë u përdorën edhe telefonatat dhe takimet e drejtëpërdrejta. Në shërbesë të shpërndarjes të informacionit u përgatitën paketa informative në mënyrë që pjesëmarrësit të informoheshin para takimit , si dhe analiza dhe prezantimi i materialeve nga ana e eksperteve. Për të

---

<sup>5</sup> [http://www.flag-al.org/Flag-AL\\_ORG\\_files/strategic%20plans/Shkodra%20Alb.pdf](http://www.flag-al.org/Flag-AL_ORG_files/strategic%20plans/Shkodra%20Alb.pdf)

## Bordi i Zhvillimit Ekonomik pranë Njësive të Qeverisjes Vendore (NJQV) si domosdoshmëri për zhvillimin dhe mirëqenien e komunitetit dhe nxitës për mirëqeverisje; Bashkia Shkodër

---

përmbyllur hapin e parë të shpërndarjes së informacionit u përdorën mediat, dhe më së shumti ato lokale, të cilat u shfrytëzuan për të informuar rreth aktiviteteve por edhe për të intervistuar titullarë të bashkisë të cilët përshkruan procesin. Hapi i dytë, *konsultimi publik* u realizua nga 6 nën hapa; krijimi i grupeve të punës, zhvillimi i ëorkshop-eve, takimet publike, anketimi përmes të cilit u krijua një analizë e përgjithshme mbi pikëpamjet dhe vizionin e bizneseve, takimet me kryetarët e bashkive si dhe nën hapi i fundit këshillimi me agjencitë e tjera. Për të realizuar fazën e tretë të programit u hartua sistemi i adresave dhe kontakteve telefonike, tek të cilat u shpërnda informacioni sipas kalendarit përkatës. Drejtimi i procesit për hartimin, monitorimin dhe vlerësimin e programit u bë nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, e mbështetur nga i gjithë stafi i bashkisë. Përsa i përket parimit të pjesëmarrjes në takime morën pjesë një grup i gjerë personash bashkë me kryetarin e bashkisë dhe anëtarë të këshillit bashkiak. Kjo pjesëmarrje u 'institucionalizua dhe u strukturua nëpërmjet Komisionit të Planifikimit të ZhEV i ngritur dhe kryesuar nga kryetari i bashkisë. Roli i komisionit ishte të hartonte e të rishikonte Planin Strategjik, dhe kjo përgjegjësi vazhdon me mbikëqyrjen dhe vlerësimin e zbatimit të planit. Struktura e Komisionit u ndërtua e tillë që mundësoi grupimin e anëtarësisë sipas fushave të zhvillimit dhe të interesit. Element thelbësor në këtë strukturë ishte dhe mbetet Ekipi Kryesor i kryesuar nga Departamenti i Zhvillimit Ekonomik të Bashkisë (DZhEB) dhe ku komuniteti i biznesit kishte një përfaqësues.<sup>6</sup> Nga sa është parë në vazhdim ky komision ka bërë një ekspertizë të mirë duke nxjerrë në pah nevojat reale. Në sajë të specialistëve të fushave të ndryshme dhe të pushtetit vendor ka pasur një orientim të saktë për strategjitë duke përcaktuar mirë prioritetet. Këto rezultojnë në raportin<sup>7</sup> e bërë nga Flag. Probleme të këtij komisioni-bord kanë qenë mungesa e vazhdimësisë, mos arritja e stadeve të monitorimit dhe raportimit dhe mos përditësimi. Duke iu referuar tezes që ky punim ngre parimit të pjesëmarrjes ky komision ndjek rrugën e duhur, por përsëri hasen vështirësi sepse sot ai nuk rezulton eficient sikurse duhej të ishte. Përpara se të shkojmë tek analiza e rritjes së efijensës do të ndalemi tek parimi i pjesëmarrjes në vendimarrje.

### 3. Parimi i pjesëmarrjes në vendimarrje

Përfshirja e komunitetit të një njësie vendore në vendimarrjet e saj mund të jetë në forma të ndryshme:

---

<sup>6</sup> [http://www.flag-al.org/Flag-AL\\_ORG\\_files/strategic%20plans/Shkodra%20Alb.pdf](http://www.flag-al.org/Flag-AL_ORG_files/strategic%20plans/Shkodra%20Alb.pdf)

<sup>7</sup> [http://www.flag-al.org/Flag-AL\\_ORG\\_files/strategic%20plans/Shkodra%20Alb.pdf](http://www.flag-al.org/Flag-AL_ORG_files/strategic%20plans/Shkodra%20Alb.pdf)

## Bordi i Zhvillimit Ekonomik pranë Njësive të Qeverisjes Vendore (NJQV) si domosdoshmëri për zhvillimin dhe mirëqenien e komunitetit dhe nxitës për mirëqeverisje; Bashkia Shkodër

---

- **Konsultim;** në procesin paraprak të diskutimeve përpara marrjes së vendimeve që ndikojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë në komunitet.
- **Bashkëpunim;** bashkëpunimi është efektiv veçanërisht në procesin e zbatimit të vendimeve që janë miratuar tashmë nga qeverisja lokale dhe që duhet të zbatohen nga komuniteti i kësaj qeverisje,
- **Përfshirje,** pëfshin angazhimin e komunitetit në të gjitha hallkat e marrjes së vendimeve nga autoritetet lokale identifikimin e nevojave, përcaktimin e prioritetëve, formulimin e vendimit, zbatimin dhe monitorimin e vendimit.

Jane disa rrugët që e bëjnë reale përfshirjen e komunitetit në vendimarrjen e qeverisjes lokale:

1. Pyetësorë: u krijojnë mundësinë autoriteteve vendore të kuptojnë qëndrimin apo opinionin e komunitetit në lidhje me një apo disa çështje lokale, të identifikojnë shqetësimet e komunitetit, apo të masin nivelin e kënaqësisë/pakënaqësisë me shërbimet që ofrohen nga struktura lokale.
2. Dëgjesa Publike: Janë takime publike që realizojnë drejtuesit edhe të zgjedhurit e strukturave vendore me komunitetin që u krijojnë mundësi pjestarëve të komunitetit të shprehin shqetësimet e tyre mbi zhvillimet lokal, vendimet apo çështje specifike lokale.
3. Fokus grupe: është diskutim në një tryezë të përbashkët me përfaqësues të komunitetit, duke i perzgjedhur në lidhje me çështjet për të cilat ka për synim mbledhjen e të dhënave.
4. Komisionet Qytetare: Këto organizime synojnë të forcojnë marrëdhëniet mes të zgjedhurve vendorë me komunitetin përmes angazhimit të qytetarëve në zhvillimin e politikave apo programeve, duke i shtuar atyre këndvështrime të ndryshme të komunitetit.
5. Konsultimi me komunitetin: Ka të bëjë me procesin që ndodh përpara marrjes së një vendimi të rëndësishëm lokal, kjo gjë i jep mundësinë gjithësecilit pjestar të komunitetit të japi këndvështrimin e tij për vendimin në fjalë.

Bordi i Zhvillimit Ekonomik duhet të përcaktojë qartë se si dhe ku zhvillohet ekonomia dhe në çfarë dimensionesh, se cilë janë aktorët që duhet të marrin pjesë. Në thelb përfshirja e aktoreve ekonomike duhet të mbulojë sektorët e biznesit nëpërmjet mekanizmave të përfaqësimit të komunitetit të biznesit dhe jo domosdoshmërisht të komunitetit në përgjithësi.

Në rastin konkret të mendojmë se pjesëmarrja e komunitetit në vendimarrje mund të organizohet në këtë mënyrë:



## Bordi i Zhvillimit Ekonomik pranë Njësive të Qeverisjes Vendore (NJQV) si domosdoshmëri për zhvillimin dhe mirëqenien e komunitetit dhe nxitës për mirëqeverisje; Bashkia Shkodër

---

- **Përfaqësimi:** Cdo njësi administrative që është pjesë e Bashkisë Shkodër pas ndarjes së re territoriale të ketë përfaqësuesin e saj me të drejtë vote në bord. Sektorët kryesorë që duhet të përfaqësohen duhet të marrin në konsideratë tipologjinë e Bashkisë që në rastin e Bashkisë Shkodër mund të jenë: tregti e shërbime, tregje, biznese prodhuese e fason, zanatet, bujqësia, turizmi dhe transporti.
- **Zgjedhja:** Duke qenë se duhet të kemi pjesëmarrje të komunitetit në bord, zgjedhja e përfaqësuesit në Bord duhet të bëhet sipas sektorë apo gjetjen e një mekanizimi përzgjedhje nga komuniteti i biznesit për përfaqësuesit e tij. Duhet të kemi përfaqësim të sektoreve bazë të administratës publike si planifikimi urban, zhvillimi ekonomik, financat, shërbimet publike dhe pastaj universiteti, ekspertë dhe pse jo keshilltarë bashkiakë.
- **Largimi:** Nëse anëtarët e komunitetit nuk janë të kënaqur nga përfaqësimi që i ka bërë përfaqësuesi i tyre në bord, kanë të drejtë të zgjedhin një përfaqësues tjetër
- **Detyrat:** Përfaqësuesi ka për detyrë të organizojë takime të ndryshme me komunitetin dhe të identifikojë problemet më të mëdha. Cdo vit duhet të bejë listën e prioritetëve që ka nevojë komunitetit i tij. Qëlimi i bordit është<sup>8</sup>:
  - Të ndërtojë kapacitete të zhvillimit ekonomik në zonën që mbulon
  - Përmirësim ekonomik dhe të cilësisë së jetesës të të gjithë banorëve
  - është një proces përmes të cilit publiku, bizneset, OJF-të, duhet të punojnë së bashku për të krijuar kushte më të mira për zhvillimin ekonomik dhe të gjenerojnë punësim.

Puna dhe detyrat specifike të bordit duhet të jenë në bashkërendim dhe me funksionet ligjore të NJQV në lidhje me zhvillimin e ekonomik. Duke ju referuar ligjit në fuqi bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik vendor:

- Hartimin e planeve strategjike të zhvillimit e të programeve për zhvillimin ekonomik vendor.
- Ngritjen dhe funksionimin e tregjeve publike dhe të rrjetit të tregtisë.
- Mbështetjen për zhvillimin e biznesit të vogël, nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panairë e reklama në vende publike.
- Organizimin e shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor, si informacioni për bizneset, aktivitetet promovuese, vënia në dispozicion e aseteve publike etj.
- Publikimin e broshurave informative, krijimin e portaleve me profil ekonomik etj
  - Dhënien e granteve financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël e të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi, duke garantuar akses të balancuar gjinor.

---

<sup>8</sup> Sipas definicionit të Bankës Botërore

# Bordi i Zhvillimit Ekonomik pranë Njësive të Qeverisjes Vendore (NJQV) si domosdoshmëri për zhvillimin dhe mirëqenien e komunitetit dhe nxitës për mirëqeverisje; Bashkia Shkodër

---

Gjithashtu në kuadër të pjesëmarrjes por dhe të transparencës sugjerohet që:

- Mbledhjet e bordit të jenë të hapura për publikun. Mbledhjet e hapura nuk kanë qenë shumë të sukseshme për shumë arsye, por kjo nuk do të thotë që nuk duhet të jenë të tilla sepse nëse realizohen të mbyllura dhe ato pak njerëz që mund të jenë të interesuar nuk do të kenë me interes për tu bërë pjesëmarrës.
- Cdo 6 muaj bordi duhet të botojë një “fletore zyrtare” ku të jenë të pasqyruara të gjithë vendimet që ai ka marrë dhe kjo ti dergohet për informacion Bashkisë
- Bordi mund të ketë një Website që të jete i azhurnuar gjatë gjithë kohës me aktivitetet dhe vendimet që merren.

## 4. Qeverisia vendore, ligji dhe bordet e zhvillimit:

### 4.1. Referenca ligjore

- Karta Evropiane e Autonomisë Vendore - Maunali permban Karten e plote mbi Autonomie e Qeverisjes Vendore
- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (1998) “Qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë ngrihet në bazë të parimit të decentralizimit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore ” (Neni 13)
- Ligj Nr. 139/2015 për Vetëqeverisjen Vendore
- Ligj Nr. 119/2014 për të drejtën e informimit
- Ligj Nr.9936, datë 26.06.2008 për “Manaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”
- Ligj Nr. 107/2015 “Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit”
- Ligj Nr. 125/2013, “Per partneritetin Publiko-Privat”
- Ligji nr. 115/2014, datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.

Në thelb të studimit për implemtimin e një politike sic është themelimi i Bordit te Zhvillimit pranë NJQV , qëndron koncepti i materializimit dhe formalizimit të këtij të fundit.

Referencat ligjore që jetësojnë një projekt të tillë, burojnë si nga ligji nr.139/2015 “Për qeverisjen vendore” ashtu si edhe nga Karta Evropiane e Autonomise Vendore e ratifikuar me Ligjin nr. 8548 dt. 11.11.1999.

Karta Evropiane e Autonomise Vendore (KEAV), në funksion te parimit te mirëqeverisjes përcakton në linjë të qartë konceptet themelore për realizimin e efektiv të përgjegjësive të sipërmarra në interes te publikut.

# Bordi i Zhvillimit Ekonomik pranë Njësive të Qeverisjes Vendore (NJQV) si domosdoshmëri për zhvillimin dhe mirëqenien e komunitetit dhe nxitës për mirëqeverisje; Bashkia Shkodër

---

## 4.2. Përfshirja e publikut

Në nenin 3 të KEAVpërcaktohet :

“E drejtë e NJQV në interes të publikut ushtrohet nga këshillat apo asamblatë e përbëra nga anëtarë të zgjedhur me votim të lirë, të fshehtë, të barabartë, të drejtpërdrejtë e universal dhe që mund të kenë organe ekzekutive përgjegjës para tyre. **Kjo dispozitë nuk i pengon qytetarët të mbliidhen në kuvende, referendume apo çdo formë tjetër të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të tyre aty ku lejohet nga ligji”.**

## 4.3. Krijimi i strukturave ndihmese, siç janë Bordet

Në Nenin 6 te KEAV “ *Përshtatja e strukturave dhe mjeteve administrative misioneve të bashkësive vendore, parashikohet:*

1. “Duke ruajtur dispozitat më të përgjithshme, të krijuara nga ligji, bashkësitë vendore mund të përcaktojnë vetë strukturat administrative me të cilat duhet të pajisen, me synimin që t'ia përshtasin ato nevojave të tyre specifike dhe të sigurojnë një drejtim efikas”.

Ndërkohë, me Ligjin Nr. 139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore” është bërë edhe përthithja e parimeve themelore të KEAV, të cilat sanksionojnë si më poshtë:

### ***Neni 3: Misioni i vetëqeverisjes vendore***

Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:

d) realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;

dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithë-përfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;

e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.

### ***Neni 9: Të drejtat dhe përgjegjësitë***

Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi:

1.1. Të drejtën dhe përgjegjësinë e vetëqeverisjes, sipas së cilës:ç) krijojnë njësi ekonomike dhe institucione në varësi të tyre. **d) krijojnë komitete, borde ose komisione për kryerjen e**

# Bordi i Zhvillimit Ekonomik pranë Njësive të Qeverisjes Vendore (NJQV) si domosdoshmëri për zhvillimin dhe mirëqenien e komunitetit dhe nxitës për mirëqeverisje; Bashkia Shkodër

---

funksioneve të veçanta sa herë që paraqitet nevoja, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore.

## ***Neni 15: Transparenca e veprimtarisë së njësive të vetëqeverisjes vendore***

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre.

## ***Neni 16: Konsultimi publik në njësitë e vetëqeverisjes vendore***

1. Organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes.

## ***Neni 20: E drejta e iniciativës qytetare***

1. Çdo komunitet, nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar të tij, ose jo më pak se një për qind e banorëve të bashkisë ka të drejtë të paraqesin për vendimmarrje në këshillin bashkiak iniciativa qytetare për çështje që janë brenda juridiksionit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.
2. Kuadri ligjor cituar më lart, nëpërmjet parimeve të mireqeverisjes si pjesmarrja, transparenca, konsultimi, garanton një proces funksional dhe efikas në shërbim të publikut.

Parashikimi që i është bërë në ligj (KEAV , ligj.139/2015) i krijimi të strukturave të vecanta dhe të specializuara, sic është Bordi i Zhvillimit pranë NJQV, për të ndihmuar procesin e përfaqesimit të qytarëve dhe të ndërmarrjes së politikave publike efikase, është një hap më tej i përparuar në procesin e mirëqeverisjes.

## ***Neni 28: Funkcionet e bashkive në fushën e zhvillimit ekonomik vendor. Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:***

1. Hartimin e planeve strategjike të zhvillimit e të programeve për zhvillimin ekonomik vendor.
2. Ngritjen dhe funksionimin e tregjeve publike dhe të rrjetit të tregtisë.
3. Mbështetjen për zhvillimin e biznesit të vogël, nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panairë e reklama në vende publike.
4. Organizimin e shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor, si informacioni për bizneset, aktivitetet promovuese, vënia në dispozicion e aseteve publike etj.
5. Publikimin e broshurave informative, krijimin e portaleve me profil ekonomik etj. 6. Dhënien e granteve financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël e të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi, duke garantuar akses të balancuar gjinor

# Bordi i Zhvillimit Ekonomik pranë Njësive të Qeverisjes Vendore (NJQV) si domosdoshmëri për zhvillimin dhe mirëqenien e komunitetit dhe nxitës për mirëqeverisje; Bashkia Shkodër

---

## 5. Diskutime, pritshmeri dhe sugjerime

### 5.1. Pritshmëri

1. Ndërtimin e një strategjie konkrete për një bord të zhvillimit ekonomik me të gjithë elementët përbërës së saj, siç janë:
  - a. Përbërja e bordit (ekspertët e fushës nga ana profesionale)
  - b. Qasjet strategjike komunikimi mes bashkisë dhe biznesit
  - c. Ofrimin e strategjive ekonomike që ofrojnë uljen e papunësisë
  - d. Qëndrueshmëri në zhvillimin ekonomik dhe si rrjedhojë në uljen e varfërisë
2. Roli i bordit :
  - a. Hartimi i strategjisë për zhvillim ekonomik duke përfshirë drejtimet kryesore
  - b. Hartimi i planit të veprimit për zhvillim ekonomik me përgjegjësitë dhe burimet
  - c. Monitorimi dhe bashkëpunimi për zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit
  - d. Organ këshillues për këshillin bashkiak për hartimin e masave dhe alokimin e burimeve në mbështje të zhvillimit ekonomik
  - e. Krijimi i platformës së bashkëpunimit për sektoret kyç të ekonomisë ndërmjet administratës bashkiake dhe komunitetit të biznesit për trajtimin periodik të problemeve të klimës së biznesit
  - f. Promovues në komunitet i zhvillimit ekonomik

Organi kordinues dhe zbatues për bordin e zhvillimit ekonomik është Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik

3. Publikimin e broshurave informative, krijimin e portaleve me profil ekonomik etj.
4. Fushat kryesore të programeve për zhvillimi ekonomik do të jenë:
  - a. Përmirësim të Klimës për investime të biznesit lokal
  - b. Investime në Infrastrukturë
  - c. Investime në zona, tregje dhe ndërtesa për biznes
  - d. Investime në Infrastrukturën soft
  - e. Inkurajim të rritjes së bizneseve lokale
  - f. Inkurajim të hapjes së bizneseve të reja
  - g. Targetim i zonave për zhvillim dhe gjenerim strategjish
  - h. Përfshirje e personave me të ardhura të vogla në punësim<sup>9</sup>
5. Bordi punon me bizneset duke :
  - a. I informuar për të gjitha proceset të cilat i prek qeverisja e Bashkisë dhe kontributi ku ato mund të japin

---

<sup>9</sup> Book: Local Economic and Employment Development Local Governance and the Drivers of Growth, By OECD

## Bordi i Zhvillimit Ekonomik pranë Njësive të Qeverisjes Vendore (NJQV) si domosdoshmëri për zhvillimin dhe mirëqenien e komunitetit dhe nxitës për mirëqeverisje; Bashkia Shkodër

---

- b. Informon për PPV, lejet e ndërtimit dhe dokumentacionin përkatës
  - c. Informon për programet qeveritare për investime, grante dhe donacione
  - d. Që një NJQV të zhvillohet në mendojme se është shumë e rëndësishme që NJQV të kuptojë si punon biznesi, cilat janë problematikat që ai has dhe të ndërtojë një rrugë komunikimi të vazhdueshme dhe formale mes Komunitetit të biznesit.
6. Bordi ofron shërbimet më poshtë për bizneset:
- a. Mundësi për të folur në emër të komunitetit të biznesit në Komisionet, mbledhjet e Këshillit Bashkiak
  - b. Adresimi i kërkesave specifike të biznesit në Këshillin Bashkiak dhe Bashki.
  - c. Përgatitja e propozimeve konkrete për aprovim në KB.
  - d. Propozim i ndryshimeve në politikën fiskale të NJQV, rishikim buxheti për investime dhe të ardhura duke garantuar zhvillim biznesi dhe mirëqenie sociale
  - e. Organizon tryeza të rrumbullakta, konferenca etj
7. Bordi punon me specialistë fushave të ndryshme si: zhvillimi social, edukimi, urbanistët, shëndeti publik dhe siguria publike, për të përmirësuar klimën e përgjithshme në:
- a. Zbutjen e varfërisë
  - b. Gjetja e zgjidhjeve për të pastrehët
  - c. Uljen e largimit nga shkollat për nivelin 9 vjeçar dhe të mesëm.
  - d. Ndhimesën në emancipimin e gruas në shoqëri. Krijimin e qendrave rezidenciale për gratë e dhunuara, edukimi dhe punësimi i tyre.

Bashkia Shkodër ka mirëpritur këtë iniciative dhe do të jetë ajo e cila do të themelojë Bordin e Zhvillimit Ekonomik në linjë dhe me këtë studim.

### 5.2. Rekomandime:

1. Ligji nr.139/2015 parashikon krijimin e bordeve pranë NJQV si njësi të specializuara në funksion të një politikbërje dhe vendimarrje të drejtë dhe efikase, por ka ende një vakum ligjor që të rregullon mënyrën e krijimit, funksionimit dhe organizimit të këtyre Bordeve". Në qoftëse do të qëndrojmë thelbit të studimit dhe do të përqafohet ideja e krijimit të Bordit të Zhvillimit pranë NJQV si një hap i mirë në reformimin e sistemit të qeverisjes vendore, grupi studimit mbetet i gatshëm të ofrojë një studim të dytë për përshtatjen e bazës ligjore për themelimin konkret të Bordeve.